



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1008 Prot.

Tiranë, më datë 18.07 2023

VENDIM
Nr. 402, datë 18.07.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.07.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit *“Rijetëzimi dhe Përmirësimi i vlerave të Kalasë së Tepelenës”* Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues SON Engineering Construction dhe zhvillues **FSHZH**, me rekomandimin:
 - Struktura e pasazhit me korten mbi murin e kalasë duhet të realizohet vetëm pasi të bëhet përllogaritja e saktë e kapacitetit mbajtës të këtij muri nga inxhinier konstruktor i licencuar. Përllogaritja e kapacitetit mbajtës duhet të bëhet bazuar në rezultatin që do të dali nga marrja në vend e kampioneve të muraturës mbi të cilin është parashikuar ndërtimi i këtij pasazhi. Bazuar në rezultatet e përllogaritjes së kapacitetit mbajtës, në rast se rezulton se muri i kalasë nuk është në gjendje të mbajë peshën e parashikuar, duhet të bëhet rishikimi i këtij projekti dhe shqyrtimi i tij në KKTKM.
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin *“Rijetëzimi dhe Përmirësimi i vlerave të Kalasë së Tepelenës”*, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit;
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për Trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, datë 17.05.2018, neni 72, pika 1 dhe 2;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
6. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

